

PROCESVERBAL
nga seanca e tetë e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 21.8.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Punonjësit nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Gorjan Shekerinov, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e tetë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 11:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së shtatë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 7.8.2025.
2. Propozim-Rregulloren e Punës për Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.
3. Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimi për furnizim të shërbimi, me vlerë të parashikuar nën pragjet e vlerës për zbatimin e Ligjit për Furnizime publike – informim të publikut për Kodin e Sjelljes në hapësirën online gjatë proceseve zgjedhore dhe referendumeve.
4. Të ndryshme.

Këshilltarja Gordana Majnova kërkoi informacion nëse do të respektohet afati për miratimin dhe nënshkrimin e Rregullores së Punës së Agjencisë nëse do të miratohet të hënën. Ajo theksoi në faktin se vendimi për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, nënshkruar nga Kryetari Afrim Gashi, ishte publikuar më 24 qershor të këtij viti.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi se afati do të respektohet. Dita e fundit e afatit prej 60-ditësh është të shtunën, por meqenëse e shtuna është ditë pushimi, afati automatikisht zhvendoset në ditën e parë të pasuese të punës, përkatësisht të hënën.

Znj. Majnova tha se pyetjen e parashtroi në kontekst të faktit se komentet e fundit mbi Rregulloren e Punës, të paraqitura nga z. Trajçe Kostov, u pranuan gjatë ditës së djeshme, pas të cilit Projekt-rregullorja e punës u dorëzua dje pasdite. Në interes të kohës për shqyrtim të hollësishëm, ajo propozoi që miratimi i Rregullores së Punës të shtyhet deri të hënën, nëse të gjithë do të pajtohen, në mënyrë që të kishte kohë të mjaftueshme për të shqyrtuar propozimin.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, propozoi që së pari të miratohet Procesverbalin, e më pas të kalohet në shqyrtimin e Projekt-rregullores, meqenëse kjo pikë është e dyta me radhë në rend të ditës.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e seancës së shtatë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 7.8.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski, lidhur me propozimin e znj. Majnova, shpjegoi se vërejtjet përfundimtare mbi Draft-Rregulloren e Punës janë marrë pardje, jo dje, ndërsa materiali për seancë ju është dorëzuar anëtarëve të Këshillit gjatë ditës së djeshme.

Znj. Majnova u pajtua me atë që u tha, por theksoi se qëndrimi i Agjencisë dhe drejtorit në lidhje me vërejtjet e z. Trajçe Kostov janë dorëzuar dje pasdite. Më pas, z. Stefanovski propozoi të hapet debat mbi propozimin e znj. Majnova për shtyrjen e shqyrtimit të Rregullores së Punës.

Znj. Majnova tha se kishte vërejtje në lidhje me mospranimin e propozimit për paragrafin 2 të nenit 16 të Rregullores së Punës nga z. Trajçe Kostov, i cili u refuzua nga Agjencia. Ajo theksoi se pajtohej me formulimin e propozuar nga z. Kostov, i cili thotë: "për shpenzimet financiare lidhur me udhëtimet zyrtare, mjetet për reprezentim, tarifat e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare, trajnimet e paguara të punonjësve, pas miratimit paraprak të Këshillit, vendos drejtori i Agjencisë". Ajo shtoi se megjithëse në pajtim me nenin 20 të LSHMAAV, drejtori është përgjegjës për ligjshmërinë e punës, në interes të transparencës gjatë shpenzimit të mjeteve, dhe duke marrë parasysh faktin se Këshilli jep pëlqimin e tij për Planin financiar dhe Planin për furnizim publik, ajo beson se ky formulim është i përshtatshëm dhe duhet të miratohet.

Z. Petar Xhurovski fillimisht parashtroi një pyetje në lidhje me identitetin e z. Trajçe Kostov, duke pasur parasysh se ai nuk e kishte deklaruar profesionin e tij dhe as nuk kishte shpjeguar pse po jepte vërejtje për Rregulloren si palë e interesuar. Xhurovski theksoi se Këshilli nuk kishte asnjë të dhënë për të përveç emrit dhe mbiemrit të tij, dhe se nuk dihej nëse kemi të bëjmë me punonjës të medias me përvojë të gjatë, gazetar, drejtor televizioni ose radioje, apo person me profesion që nuk ka lidhje me punën e ASHMA-së. Prandaj, ai deklaroi se nuk donte të diskutonte lidhur me vërejtjet e tij, duke theksuar se Këshilli në të ardhmen përsëri mund të përballet me situata të ngjashme. Ai gjithashtu theksoi se me punën e Agjencisë udhëheq Drejtori dhe Këshilli, dhe në këtë drejtim, ai theksoi se Këshilli nuk duhet të lejojë që persona të jashtëm të ndërhyjnë në punën e tij. Së fundmi, ai i propozoi kryetarit

Stefanovski që të shqyrtohet mundësia e anashkalimit të diskutimit dhe shqyrtimit të vërejtjeve të paraqitura nga z. Trajçe Kostov.

Z. Trajçevski tha se do të jepte shpjegim në lidhje me propozimin e këshilltares Majnova. Ai shpjegoi se Drejtori dhe Shërbimi profesional drejtuar anëtarëve të Këshillit rregullisht dorëzojnë raporte tremujore që përmbajnë parametra të detajuar financiarë. Përveç kësaj, Agjencia në çdo tre muaj mban takim publik në të cilin shpjegohen të gjitha aspektet e veprimtarisë së saj, përfshirë dhe ato financiare. Në këtë mënyrë transparenca, në pajtim me Ligjin, sigurohet plotësisht. Sipas tij, nëse do të kishte nevojë në Ligj të përfshihej ajo që propozon z. Trajçe Kostov, kjo do të ishte deklaruar shprehimisht. Trajçevski gjithashtu theksoi se vërejtjet që anëtarët e Këshillit i dhanë një muaj më parë në lidhje me Draft-rregulloren e Punës dhe vërejtjet e z. Kostov janë identike, pasi ato i referohen çështjeve të njëjta. Të gjitha vërejtjet u shqyrtuan, dhe është pranuar gjithçka që është në përputhje me Ligjin. Lidhur me vërejtjet e z. Kostov, ai shpjegoi se shërbimet gjatë gjithë ditës së djeshme kanë punuar me përkushtim për të ofruar shpjegim ligjor për të gjitha propozimet e dorëzuara. Ajo që iu paraqit anëtarëve si material për seancën përfaqëson mendim dhe shpjegim nga sektori juridik i Agjencisë, në harmonizim me Ligjin. Së fundmi, Trajçevski theksoi se vendimi përfundimtar se si do të votojë Këshilli varet nga secili anëtar individualisht.

Z. Xhurovski përsëri propozoi që mos të diskutohen vërejtjet e bëra nga z. Trajçe Kostov dhe të kalohet në pikat e radhës të rendit të ditës, duke pasur parasysh se ai nuk ishte identifikuar dhe pas emrit dhe mbiemrit të tij mund të fshihej dhe punonjës i Agjencisë.

Në këtë drejtim, z. Trajçevski konfirmoi se është e vërtetë që vërejtjet janë paraqitur nga person për të cilin nuk ka siguri nëse është i vërtetë apo jo. Ai shtoi se Agjencia dhe Këshilli nuk kanë mekanizma dhe nuk janë ekspertë për ta përcaktuar këtë, sepse sot kushdo mund të hapë e-mail adresë dhe të dërgojë propozime. Megjithatë, në lidhje me propozimin për të anashkaluar vërejtjet, Trajçevski shpjegoi se materiali i paraqitur ofron qëndrimin zyrtar të Agjencisë si përgjigje të vërejtjeve të z. Kostov. Në këtë mënyrë, ato nuk anashkalohej, sepse ASHMA është e detyruar t'i përgjigjet çdo kërkesë të dorëzuar në institucion, pavarësisht nëse ajo buron nga person real apo ndoshta fiktiv.

Znj. Majnova theksoi se, pavarësisht identitetit të personit që ka paraqitur vërejtje, kur miratohet akt nënligjor - në këtë rast Rregullorja e Punës - ai publikohet në ueb-faqen dhe vihet në debat publik, që do të thotë se secili ka të drejtë të japë vërejtjet e tyre. Lidhur me llogaridhënien financiare, Majnova theksoi se është e saktë që Këshilli nuk ushtron kontroll të rreptë financiar ose llogaridhënie të detajuar, por në frymën e transparencës dhe shpenzimit të përgjegjshëm të mjeteve të Agjencisë, mendon se formulimi i propozuar është adekuat. Prandaj, ajo i qëndron propozimit të saj që në nenin 16 paragrafi 2 të futet aktvendimi i propozuar.

Z. Xhurovski shprehu shqetësim drejtuar Këshillit mund çdo ditë të arrijnë vërejtje në lidhje me punën e tij nga persona të jashtëm të panjohur, dhe nuk dihet nëse këta persona janë të arsimuar në mënyrë adekuate dhe nëse kanë pikë të ngjashme me fushën. Ai pyeti nëse duhet të reagohej dhe t'u jepet përgjigje këtyre vërejtjeve ose duhet të injorohen, sepse nëse personi është vërtet i interesuar për punën e Agjencisë dhe Këshillit, ai duhet të marrë pjesë në takim ku mund të hapet diskutim. Ai gjithashtu u habit se si z. Kostov ka ardhur tek e-mail adresat e anëtarëve të Këshillit kur ato nuk janë shpallur publikisht. Ai paralajmëroi se po afrohen zgjedhje me rëndësi të jashtëzakonshme për ASHMA dhe se Këshilli duhet të përqendrohet në çështje shumë më të rëndësishme sesa propozimet e Kostovit. Ai theksoi se

në të ardhmen mund të arrijnë një numër i madh vërejtjesh të ngjashme, të cilat do ta ngarkonin shërbimin dhe mund të çonin në ngadalësim të punës pikërisht gjatë periudhës zgjedhore. Si mundësi, propozoi që të hetohet nëpërmjet e-mail adresës se kush fshihet pas emrit Trajçe Kostov. Së fundmi, ai nënvizoi se nuk e mbështet diskutimin dhe shqyrtimin e vërejtjeve të paraqitura nga ky person në kuadër të seancës si mënyrë e punës së rregullore dhe kërkoi që qëndrimi i tij të regjistrohet në procesverbal.

Z. Trajçevski, në lidhje me diskutimin e znj. Gordana Majnova, theksoi se Këshilli nuk ka metodologji për vlerësimin e punës së drejtorit dhe zëvendësit të drejtorit. Ai theksoi se, nëse ata nuk i përmbushin detyrimet e tyre ligjore, Ligji parashikon saktësisht procedurë për shkarkimin e tyre, por jo edhe për vlerësim.

Znj. Majnova shpjegoi se kishte pasur një keqkuptim, pasi ajo nuk i ishte referuar fare vlerësimi. Ajo theksoi se vërejtja e saj i referohej ekskluzivisht nenit 16, paragrafi 2, i cili rregullon vendimet financiare që lidhen me shpenzimet, dhe jo vlerësimin të punës së drejtorit ose zëvendësit të drejtorit.

Z. Trajçevski shpjegoi se shpenzimet për udhëtime zyrtare, si dhe fletpagesë udhëtimi të drejtorit dhe zëvendësit të drejtorit, nënshkruhen nga Kryetari i Këshillit. Nëse shpenzohen mjete për qëllim të udhëtimi zyrtar, kryetari ose zëvendësi i kryetarit të Këshillit nuk do t'i nënshkruajnë ato shpenzime. Shumat për reprezentim përcaktohen nga plani financiar vjetor. Gjithashtu, është përgjegjës që çdo tre muaj të njoftohen antarët, në veçanti për shpenzimet, dhe e gjithë kjo do të përfshihet në raportet tremujore. Ai theksoi se nga mjetet me të cilat disponon Agjencia vetëm pjesë janë buxhetore, ndërsa për shpenzime të paligjshme ose pa qëllim vijon përgjegjësi penale.

Znj. Majnova theksoi se Këshilli jep pëlqim për planin financiar, prandaj formulimi në nenin 16 paragrafi 2 është i përshtatshëm. Ajo shtoi se propozimi nuk i referohet paragrafit 3, por paragrafit 2, i cili rregullon shpenzimet financiare që lidhen me udhëtimet zyrtare, mjetet e përfaqësimit, nëtarësime në organizatat ndërkombëtare dhe pagesën e trajnimeve të punonjësve, ku me miratim paraprak të Këshillit vendos drejtori. Ajo kujtoi se diskutimi ka të bëjë me këtë formulim, dhe jo me vlerësimin e drejtorit dhe zëvendësit të drejtorit.

Z. Trajçevski shpjegoi se për anëtarësimin vjetor në EPRA, Këshilli tashmë ka votuar në një rën nga seancat e mëparshme. Këshilli jep miratim, ndërsa drejtori njofton udhëheqësin e sektorit për financat, i cili më pas bën pagesën në bankë. Lidhur me trajnimet, drejtori vendos për trajnimet deri në 500 euro, ndërsa për trajnimet mbi 500 euro vendimin e merr Këshilli. Trajçevski theksoi se të gjitha praktikat e lartpërmendura tashmë po zbatohen dhe se ai nuk e kupton pse duhet të pranohet propozimi i z. Kostov.

Znj. Majnova shtoi se anëtarësimet në organizatat ndërkombëtare nuk janë të diskutueshme, sepse këto janë kompensime që secili vend i paguan nëse është anëtar, dhe se kjo nuk paraqet problem apo çështje të diskutueshme.

Z. Xhurovski theksoi se nuk kishte çështje të diskutueshme, pasi bëhet fjalë për praktika që respektohen dhe drejtori i kishte shpjeguar shumë saktë. Ai pyeti nëse ishte e mundur të vazhdohej me shqyrtimin e pikave të radhës në rendin e ditës, duke pasur parasysh se të gjitha procedurat ishin në pajtim me Ligjin dhe drejtori i Agjencisë i përmbahej parimeve ligjore, ashtu siç duhet të përmbahen edhe anëtarët e Këshillit.

Z. Trajçevski tha se Agjencia ka punësuar revizor të brendshëm i cili ka të drejtë të hyjë në të gjitha dokumentet pa miratimin e drejtorit. Gjithashtu, në fund të vitit, angazhohet

revizor ndërkombëtar i cili kryen revizion të Agjencisë, ndërsa inspektim mund të kryhet edhe nga Enti Shtetëror për Revizion.

Z. Stefanovski u pajtua me shpjegimin e drejtorit, duke theksuar se në pajtim me LSHMAAV, ndiqen të gjitha procedurat ligjore. Ai gjithashtu mbështeti procedurën për nënshkrimin e urdhëresave të udhëtimit, duke theksuar se ekziston një filtër që parandalon keqpërdorimin e mjeteve.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli vuri në dukje se, si të gjithë anëtarët e Këshillit, ka marrë nëpërmjet postës elektronike vërejtjet nga personi Trajçe Kostov në lidhje me Draft-Rregulloren e Punës. Ajo tha se nuk i përket fellave mediatike, por pyeti nëse dikush e njihnte z. Kostov. Ajo është njoftuar se kushdo mund të paraqesë propozime, por shprehu ankesë për shërbimin që duhej të investojë përpjekje të konsiderueshme për person që nuk është identifikuar dhe për të cilin nuk është e qartë se nga cili media vinte. Vërzivolli theksoi se Agjencia duhej të përgjigjej, por kjo paraqet barrë të panevojshme për shërbimin dhe për anëtarët e Këshillit. Ajo kujtoi se më parë, kgjatë miratimit të Rregullores çdo propozues identifikohet qartë, për shembull, Qendra për Zhvillimin e Medias, në mënyrë që publiku të dinte se kush ishte subjekti përkatës. Ajo theksoi se vërejtjet e tij do të publikohen në ueb-faqen e internetit të Agjencisë ndërsa organi rregullator duhet të jetë transparent në lidhje me atë se cili punonjës i medias i ka paraqitur. Këshilltarja propozoi të shqyrtohet mundësia për iniciimin e procedurës duke angazhuar person profesional për përcaktimin e autorit të vërtetë të mesazhit në e-mail, nga cili server është dërguar dhe cili person qëndron pas komenteve. Ajo vuri në dukje se nëse ajo vetë do të paraqiste komente për akt nënligjor, do të nënshkruhej dhe do të tregonte se nga cili institucion vinte. Vërzivolli theksoi se Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale është institucion me reputacion me detyrim ligjor ndaj publikut për transparencë të informacionit dhe se është e padrejtë ndaj shërbimit profesional që ka investuar përpjekje të jashtëzakonshme për t'iu përgjigjur personi të pafirmosur.

Z. Xhurovski u pajtua me prezantimin e saj.

Z. Trajçevski deklaroi se nuk është e nevojshme të sillen një përfundim formal dhe nëse anëtarët e Këshillit pajtohen, Agjencia mund zyrtarisht të kontaktojë me Sektorin e Krimit Kibernetik për të përcaktuar se nga cila IP-adresë është dërguar e-mail mesazhi.

Znj. Gordana Majnova kërkoi shpjegim nga Shërbimi profesional nëse një dokument me interes publik, kur vihet në debat publik, i jep të drejtën kujt do për të paraqitur komente.

Z. Trajçevski u përgjigj se nuk diskutohet që të gjithë kanë të drejtë të paraqesin komente në kuadër të debati publik, por problemi lind nëse personi që paraqet vërejtjet nuk përdor identitetin e tij të vërtetë.

Majnova parashtrroi pyetje nëse komentet e personit fyenin dinjitetin e anëtarëve të Këshillit apo të drejtorit të Agjencisë dhe nëse Agjencia ishte kompetente për të hetuar krimin e organizuar dhe për të kërkuar IP-adresa, duke vënë në dukje se kjo nuk ishte punë e Agjencisë.

Z. Xhurovski deklaroi se personi Trajçe Kostov është fiktiv dhe se, sipas mendimit të tij, buron nga vetë Agjencia dhe se kjo duhet të hetohet.

Megjithatë, znj. Majnova theksoi se nuk ka absolutisht asnjë nevojë për të kryer hetim dhe se Këshilli thjesht mund të pranojë ose refuzojë vërejtjet e paraqitura nga Trajçe Kostov.

Z. Stefanovski informoi se Shërbimi profesional gjatë ditës së djeshme miratoi disa nga propozimet e Trajçe Kostovit, pasi ato ishin në pajtim me kornizën ligjore dhe nuk shiheshin kontroverse në vërejtjet e pranuar.

Këshilltarja Cvetanka Minovska shprehu shqetësim se shumë kohë në seancë po i kushtohej personit Trajçe Kostov. Ajo theksoi se Draft-Rregullorja e Punës ishte publikuar në urb-faqen dhe 30 ditë diskutim publik dhe se nuk e dinte nëse shërbimi ishte përballur me situatë të tillë më parë - duke marrë propozime nga person i paidentifikuar. Ajo shtoi se nëse situata të tilla do të kishin ndodhur, shërbimi duhej të kishte reaguar menjëherë dhe të mos u ishte përgjigjur vërejtjeve të tilla. Minovska gjithashtu parashtroi pyetje në lidhje me kompetencat e Këshillit sipas nenit 15 të Rregullores së Punës, duke vënë në dukje se neni i referohet marrjes së vendimit të drejtorit të Agjencisë, punësimit, shkarkimit nga puna dhe çështjeve të ngjashme. Ajo kërkoi që sektori juridik të shpjegojë se çfarë ndodh në rast nëse ndonjë i punësuar paraqet ankesë kundër një vendimi të drejtorit ose udhëheqësi për rrimërim, masë disiplinore ose ngritje në detyrë: a është Këshilli i detyruar ta pranojë vendimin apo mund të deklarojë se nuk pajtohet dhe çfarë vijon më pas.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik Cvetanka Mitrevska, shpjegoi se në situatë të tilla, kur drejtori merr aktvendim për masë disiplinore ose ricaktim në pozicion më të ulët pune, punonjësi ka të drejtë për ankimim. Ankimimi i paraqitet Këshillit, i cili është i detyruar ta shqyrtojë, por nuk është i detyruar ta pranojë atë. Së bashku me ankimimim paraqitet i gjithë dokumentacioni, të cilin Këshilli e shqyrton për të vlerësuar situatën.

Këshilltarja Cvetanka Minovska theksoi se pyetja e saj nuk i referohet vetëm procedurave disiplinore ose ricaktimit në tjetër vend pune. Ajo dha shembull - nëse një punonjës reagon në lidhje me ngritjen në detyrë të një punonjësi tjetër, cilat do të ishin kompetencat e Këshillit në këtë rast? Ajo shtoi se nuk shihet kompetencë të tillë të parashikuar në Rregulloren e Punës.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik Cvetanka Mitrevska, shpjegoi se, mbi të gjitha, këto janë të drejta personale, por nëse një punonjës reagon ndaj ngritjes në detyrë të një punonjësi tjetër, atëherë ankesa duhet t'i paraqitet drejtorit, sepse vendimin e ka marrë drejtori, jo Këshilli.

Z. Trajçevski dha një shpjegim më të detajuar. Ai theksoi se, nëse bëhet fjalë për procedurë disiplinore, ngritje në detyrë ose ulje në detyrë të një punonjësi, procedura është e rregulluar qartë. Në rast të shkeljes së ligjeve ose akteve nënligjore ose Kodit të Sjelljes së Agjencisë, konstatimi nuk bëhet drejtpërdrejt nga drejtori, por nga udhëheqësit e sektorëve. Drejtori ka kompetencë të konstatojë shkelje midis vetë udhëheqësve të sektorëve dhe tek udhëheqësi i Sektorit për revizion të brendshëm. Nëse përcaktohet mundësi për shkelje, formohet komision disiplinor që mer vendim nëse ka shkelje dhe, nëse po, çfarë mase duhet të shqiptohet. Komisioni përbëhet nga udhëheqës ose zëvendës në të njëjtin nivel hierarkik si personi për të cilin po zhvillohet procedura. Masat mund të jenë të ndryshme – dënim me të holla, pezullim, deri në shkarkim, megjithëse, siç theksoi, në Agjencion deri më tani nuk ka pasur raste heqje dorë. Punonjësi ndaj të cilit është shqiptuar masë ka të drejtë ankimimi në Këshill. Ankimimi i paraqitet Këshillit së bashku me të gjithë dokumentacionin: aplikimi, procesverbalet e komisionit disiplinor dhe vendimin e drejtorit. Këshilli mund t'i pranojë ose ta refuzojë ankimimin. Nëse ankimimi pranohet, vendimi i Komitetit Disiplinor dhe i drejtorit

rrëzohet. Nëse Këshilli nuk e pranon ankimimin, vendimi mbetet në fuqi. Në këtë rast, punonjësi ka të drejtë të kërkojë mbrojtje gjyqësore.

Trajçevski theksoi se askush nuk ankohet për ngritje në detyrë, por ankimimet më shpesh kanë të bëjnë me ri-caktimin në pozicion më të ulët pune. Në situata të tilla, pa formuar komision, punonjësi ka të drejtë të ankohet në Këshill, i cili shqyrton argumentet e drejtorit dhe punonjësit dhe merr vendim. Nëse ankesa pranohet, drejtori është i detyruar ta kthejë punonjësën në pozicionin e mëparshëm të punës.

Z. Xhurovski pyeti nëse kur punonjësi riemërohet në pozicion më të ulët pune, paga e tij mbetet e njëjtë apo ulët.

Z. Trajçevski shpjegoi se kjo varet nga situata konkrete. Nëse person transferohet nga drejtues sektori në pozicion zëvendës udhëheqës sektori, atëherë vendet e punës janë të njëjta pjesërisht dhe është e mundur që paga të mbetet e njëjtë. Megjithatë, nëse punonjësi transferohet nga pozicioni udhëheqës sektori në udhëheqës njësie, atëherë paga do të ulët. Ai informoi se në dhjetë vitet e fundit në Agjenci ka pasur vetëm dy raste të tilla. Në rastin e parë, punonjësja ngriti padi, por me vendim të Gjykatës së Lartë ankimimi i saj u refuzua. Rasti i dytë nuk është paraqitur ende në gjykatë.

Këshilli i Agjencisë, me 6 vota "pro" dhe një abstenim nga znj. Majnova, miratoi Rregulloren e Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, me tekstin e propozuar.

Me hyrjen në fuqi të Rregullores së lartpërmendur ndalon (pushon) së vlefshmi Rregullorja e Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr. 01-4351/1 datë 29.8.2014 dhe Rregullorja me nr. 01-2949/1 datë 30.5.2019, për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Rregulloren e Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele e publikon në ueb-faqen të Agjencisë.

Rregullat e punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele të publikohet në tabelën e njoftimeve të Agjencisë.

Z. Trajçevski i përgëzoi anëtarët e Këshillit për miratimin e Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, duke vënë në dukje se është një dokument thelbësor për funksionimin e institucionit. Ai i falënderoi për bashkëpunimin e tyre në përgatitjen e saj, për udhëzimet e pranuar nga Spektori për çështje juridike dhe uroi punë të suksesshme në periudhën e ardhshme pesëvjeçare në zbatimin e dispozitave të saj.

Z. Stefanovski informoi se, në pajtim me Ligjin, pas miratimit të Rregullores, në afat prej 15 ditësh duhet të shpallet konkurs për zgjedhjen (emërimin) e drejtorit dhe zëvendësit të drejtorit të Agjencisë. Megjithatë, meqenëse për momentin janë shpallur zgjedhjet, kjo procedurë do të zbatohet pas përfundimit të tyre, përkatësisht pas shpalljes së rezultateve përfundimtare.

Z. Xhurovski kërkoi sqarime shtesë në lidhje me afatet për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e drejtorit dhe zëvendësit të drejtorit.

Z. Stefanovski saktësoi se Ligji parashikon që në rrethana normale pa zgjedhje, afati prej 15 ditësh do të fillojë të llogaritet menjëherë pas miratimit të Rregullores së Punës.

Megjithatë, meqenëse aktualisht janë duke u zhvilluar ugjedhjet, afati do të fillojë të llogaritet pas përfundimit dhe mbylljes së tyre zyrtare nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

Z. Xhurovski theksoi se Agjencia aktualisht ka shumë detyrime në vazhdim dhe se Këshilli dhe drejtori duhet të përqendrohen në prioritetet reale të punës. Ai theksoi se duhet të ketë koordinim të ndërsjellë, pa të cilin nuk mund të funksionojë, dhe sigurisht, që çdo seancë të jetë në pajtim të plotë me dispozitat ligjore.

Pika 3

Udhëheqësja e Sektorit për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit - Shef kabineti, mr. Daragica Ljubevska, shpjegoi propozimin për dhënien e miratimit për marrjen e vendimi për furnizim të shërbimi, me vlerë të parashikuar nën pragjet e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik - informimin e publikut për Kodeksin e Sjelljes në hapësirën online gjatë proceseve zgjedhore dhe referendumeve. Ajo shpjegoi se Kodeksi është përpiluar në vitin 2023 me mbështetjen e OSBE-ODIHR-it, dhe në partneritet me Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë, Institutin Maqedonas të Medias, Këshillin e Etikës, Institutin për Studime të Komunikimit dhe Fondacionin "Metaformosis". Kodeksi përfshin sjelljen e partive politike, kandidatëve të tyre dhe kandidatëve të pavarur në hapësirën online, duke përfshirë rrjetet sociale gjatë cikleve zgjedhore dhe referendumeve, si dhe botimet online të radiodifuzerëve, mediave online, verifikuesve të fakteve, influencerëve dhe subjekteve të tjera që mund të ndikojnë te publiku në funksion të një fushate gjatë zgjedhjeve. Për monitorimin e respektimit të Kodeksit është formuar trup koordinues, i cili përbëhet nga përfaqësues të organizatave që tashmë i cituam. Meqenëse Kodeksi zbatohet vetëm gjatë cikleve zgjedhore, trupi koordinues funksionon vetëm nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundimin e tyre. Ajo deklaroi se informimi i publikut do ta arrijë qëllimin e tij dhe do të ketë ndikim efektiv vetëm nëse zbatohet gjatë zgjedhjeve. Ideja është të hapen profile në Facebook dhe Instagram për Kodeksin online, të cilat do të jenë të lidhura me ueb-faqen të krijuar për këtë qëllim, www.izborenkodeksonline.mk dhe do të krijohen mesazhe dhe video në gjuhën maqedone dhe gjuhën shqipe, të cilat do të plasohen (vendosen) në rrjetet sociale Facebook dhe Instagram me intensitet dy herë në javë. Në këtë mënyrë, pritet të rritet ndërgjegjësimi i subjekteve të interesuara për përgjegjësinë e tyre gjatë kryerjes së fushatës në hapësirën online, si dhe përfshirja më e madhe e publikut në njohjen dhe raportimin e çdo mosrespektimi të mundshëm të parimeve dhe standardeve për kryerjen e fushate online. Furnizimi i këtij shërbimi nuk është parashikuar në Planin Vjetor për furnizim publik, sepse shërbimi është me vlerë të parashikuar nën pragjet e vlerës për zbatimin e Ligjit për Furnizimin Publik. Për të siguruar shërbimin në fjalë, u paraqitën tre oferta, nga të cilat më e favorshme financiarisht është ajo në shumën prej 59,000.00 dinarësh pa TVSH. Mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë, prandaj propozohet që Këshilli i Agjencisë ta pranojë propozimin dhe t'i japë miratim drejtorit për furnizimin e shërbimit - informimin e publikut për Kodeksin e Sjelljes në hapësirën online gjatë proceseve zgjedhore dhe referendumeve në shumën prej 59,000 dinarësh pa TVSH.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli pyeti pse në ofertë thuhet se duhet të shpenzohen 40,000.00 denarë për reklama, pasi në ofertat e tjera kufizim të tillë nuk kishin.

Udhëheqësja Ljubevska shpjegoi se kjo është kusht e specifikimit teknik dhe se në njoftime duhet të shpenzohen së paku 40,000.00 denarë.

Znj. Vërzivolli theksoi se oferta nuk është shkruar qartë dhe se mund të ketë gabim teknik në ofertën e përzgjedhur, përkatësisht që çmimi prej 40,000 denarësh nuk është deklaruar saktë - ndoshta mungon një zero ose, përndryshe, ka një zero më shumë.

Udhëheqësja Ljubevska shtoi se janë dorëzuar tre oferta me shuma të ndryshme, dhe më e ulëta ishte 59,000 denarë pa TVSH. Megjithatë, kushti nga specifikimi teknik vlen për të tre operatorët ekonomikë – për reklama duhet të shpenzohen së paku 40,000.00 denarë.

Z. Trajçevski theksoi se ofertës i mungojnë dy zero, përkatësisht pas zeros së katërt duhet të vendoset presje dhe duhet të shtohet një zero tjetër.

Znj. Vërzivolli pyeti se cila është procedura kur paraqitet ofertë teknikisht e pasaktë - a do të votohet apo operatori duhet të paraqesë të re.

Z. Trajçevski shpjegoi se në marrëveshje me kryetarin e Këshillit, z. Stefanovski, është parashikuar të hënën ose të martën të mbahet edhe një seancë. Propozoi të komunikohet me operatorin ekonomik për të paraqitur ofertë teknikisht dhe financiarisht të drejtë, ndërsa pika të shtyhet për të hënën.

Anëtari i Këshillit Viktor Pavlovski tha se do të bënte pyetje në lidhje me konceptin e Kodeksit. Ai theksoi se Agjencia është e listuar si pjesë e saj dhe se zyra përfaqësuese ndodhet në Agjenci, dhe nga ana tjetër, ajo merr pjesë në vendimmarrje si një nga gjashtë anëtarët. Sipas Kodeksit dhe Rregullores, Trupi Koordinues funksionon nga donacionet. Pavlovski pyeti nëse mjetet e propozuara janë donacion të Agjencisë, përkatësisht si Agjencia merr pjesë Agjencia me këto mjete. Ai gjithashtu kërkoi shpjegim mbi çfarë baze Agjencia jep mjete për diçka për të cilën është vetëm anëtare, duke pasur parasysh se Kodeksi nuk është në pronësi të Agjencisë.

Z. Trajçevski shpjegoi se Agjencia merr pjesë në aktivitete në shoqata të ndryshme, ku sipas Ligjit, ka kompetencë ligjore. Si shembull, ai përmendi Rrjetin për arsimim mediatik, i cili ka mbi 70 anëtarë, duke përfshirë ministri, institucione të arsimit të lartë, media shtetërore dhe private, televizione, radio, media online, si dhe individë. Sipas Ligjit, Agjencia ka detyrimin të zhvillojë arsimim mediatik. Nëse nuk formon rrjet të tillë, i cili përfshin sistemin arsimor, ministritë dhe sektorin joqeveritar, subjektet e tjera nuk do ta kryejnë këtë aktivitet në mënyrë të pavarur. Arsyeja e parë është kapaciteti teknik - roli i shtetit, pra Agjencisë, është të sigurojë hapësirë fizike për takime, të hapë dhe administrojë ueb-faqe për rrjetin. Ueb-faqe të ngjashme tashmë ekzistojnë për arsimim mediatik dhe gjininë në media. E vetmja mënyrë për të përfshirë të gjitha palët e interesuara, kur Agjencia ka kompetencë, është të koordinojë të gjithë shoqërinë. Përndryshe, megjithëse Kodeksi është miratuar, realisht nuk do të jetë në gjendje të funksionojë. Sipas z. Trajçevski, këto aktivitete organizohen kryesisht për hir të Agjencisë, por me qëllim përfshirjen e të gjitha subjekteve përkatëse në arritjen e progresit. Ai shtoi se, sipas treguesve të arsimimit mediatik, shteti vlerësohet sipas aktiviteteve të Agjencisë. Nëse organizatat joqeveritare dhe institucionet arsimore nuk funksionojnë, Agjencia nuk mund të mbetet pasive, sepse roli i saj është ligjor, ndërsa roli i sektorit joqeveritar është moral. Prandaj, Agjencia duhet të jetë bashkëfinancuese ose financuese e aktiviteteve të tilla, nga ku mjetet e investuara janë minimale, por që kontribuojnë në stimulimin e proceseve shoqërore. Trajçevski theksoi se financimi i formimit të Kodeksit dhe organizimi i eventeve në të cilën morën pjesë pothuajse të gjitha partitë politike u sigurua nga ODIHR në Varshavë.

Viktor Pavlovski tha se ky është procesi i radhës, në të cilin Agjencia do të shfaqet si financuese e të gjithë aktivitetit dhe do të jetë trupi që ofron mbështetje financiare, ndërsa

vendimet në kuadër të procesit nuk varen nga Agjencia. Ai theksoi se në këtë mënyrë Agjencia ka autoritetin më të madh midis të gjithë anëtarëve, por shfaqet kryesisht si sponsor.

Z. Trajçevski shpjegoi se opsioni tjetër do të ishte të mos organizohej aktiviteti, por nga ana tjetër, Kodeksi është miratuar dhe ekziston Trup Koordinues në të cilin nuk mund të jetë vetëm Agjencia. Thirrja për pjesëmarrje në Trupin Koordinues u hap dhe u shpall në vitin 2023 gjatë organizimit të aktiviteteve me ODIHR-in dhe në të u përfshinë ata që aplikuan. Në të ardhmen mun të përfshihen gjithashtu dhe persona të tjerë. Ai kujtoi se gjatë zgjedhjeve të fundit kishte vetëm dy ankesa që Trupi Koordinues i shqyrtoi. Në këtë mënyrë, zgjerohen aktivitetet për të kapërcyer pasivitetin e pjesëmarrësve në procesin zgjedhor dhe medias, me qëllim monitorimin e ndikimit të mediave sociale dhe platformave të internetit, i cili është shumë më i madh sesa reflektohet në procesin real zgjedhor. Ai gjithashtu theksoi se sipas Kodit Zgjedhor , 75% e reklamave politike me pagesë i referohen radios dhe televizionit. Sipas tij , ndikimi i radios dhe televizionit është shumë më i vogël se 75%. Ai theksoi se për zgjedhjet e ardhshme, nga dy institucione ndërkombëtare janë siguruar dy softuerë që do të implementohen për Agjenci që të mund të monitorojë rrjetet sociale, influencuesit. Ai theksoi se ASHMA duhet të jetë proaktive nëse dëshiron të ndërtojë imazh të fortë institucional, veçanërisht derisa të ndryshohet ligji, ose të jetë plotësisht e përgatitur kur të ndodhin ndryshime ligjore, në mënyrë që të mund menjëherë të reagojë dhe të veprojë në mënyrë efektive.

Në pyetjen e Viktor Pavlovski, se kush do të jetë përdorues i dy softuerëve të rinj, drejtori Trajçevski shpjegoi se ato do të përdoren ekskluzivisht nga Agjencia, me qëllim që të më lehtë dhe në mënyrë më efikase të monitorohen përmbajtjet në rrjetet sociale dhe aktivitetet e influencuesve. Përveç kësaj, Trajçevski informoi se Agjencia po zbaton aktivitete të tjera dhe se, nëse paraqitet mundësia, do të ishte shumë e dobishme që pjesë e tyre të financohen plotësisht. Ai kujtoi se, pas miratimit të Kodeksit dhe formimit të Trupit Koordinues, të gjitha aktivitetet deri në atë moment u mbështetën financiarisht nga OSBE/ODIHR.

Këshilli i Agjencisë njëzëri për vazhdimin e seancës së tetë e anuloi Pikën nr.3 - Propozim për dhënien e miratimit për miratimin e vendimit për furnizim të shërbimi, me vlerë të parashikuar nën pragjet e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik - informimin e publikut rreth Kodeksit të Sjelljes në hapësirën online gjatë proceseve zgjedhore dhe referendumeve.

Pika 4

Të ndryshme

Nuk pati diskutim nën pikën "Të ndryshme".

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,**

Mr. Sasho Stefanovski

